



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 4528 prot.

Tiranë, më 28.10.2024

Shpallje e kërkesës për aplikime për hartues të testeve të Maturës Shtetërore

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për hartues të fondit të pyetjeve për MSH 2025.

Kriteret:

Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë hartues i testeve:

Kandidati për hartues të testeve në provimet kombëtare është mësuesi që:

- ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues.
- ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor.
- ka të paktën kategorinë e kualifikimit "Mësues i kualifikuar" dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën "Shumë mirë".
- preferohet të ketë përvojë në hartimin e pyetjeve për provimet kombëtare.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ CV e aplikantit sipas modelit Europass;
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të ZVAP përkatëse.
- ✓ Fotokopje të noterizuar të librezës së punës.
- ✓ Kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit, ku të jetë vlerësuar me të paktën "Shumë mirë".
- ✓ Vërtetim që ka 10 (dhjetë) vitet e fundit përvojë pune si mësues në AML.
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm.

Procedura e aplikimit:

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me rrugë postare në adresën e mëposhtme:

*Qendra e Shërbimeve Arsimore
Blv. Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

Aplikimet mund të dërgohen në rrugë postare nga data 28.10.2024-01.11.2024.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurora Balliu

